

# S T A T U T

## I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “TEUTA SAILING” SHPK

#### PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Ortakët

Shoqëria “TEUTA SAILING” SHPK, themelohet nga një ortak i vetem ortake që eshte Bujar MERSINI, atesia: Xhaferri, amesa: Laje, i lindur ne Sallbeg, Durrës, me 14.01.1942, banues ne Durrës, Lagja 1, Rruga Taulantia, Kulla 2/8, me karte identititeti nr. 0228238, numer personal E201140541, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar.

##### Neni 2 Emërtimi i shoqërisë

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “TEUTA SAILING” SHPK., (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

##### Neni 3 Selia e shoqërisë

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “TEUTA SAILING” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Durrës, Lagja nr. 1, Rruga “CURRILAVE”, pallatet e Kastratit.

3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, në përpunje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

##### Neni 4 Forma ligjore

4.1 Shoqëria tregtare “TEUTA SAILING” SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

##### Neni 5 Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë nga data e regjistrimit deri me datë 31.12.2030.

##### Neni 6 Objekti i aktivitetit

Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie:

- Menaxhimin e shërbimeve dhe të strukturave portuale të të gjitha tipeve, aktivitetet e tregtisë detare, si dhe ato që lidhen me to;
- Ushtrimin e të gjithë veprimitarive të shërbimeve detare dhe portuale të anijeve e mjeteve offshore, në portet dhe ujërat kombëtare dhe ndërkontinentale, të tillë pa kufizim, si rimorkimi i mjeteve lundruese, shpëtimi i jetës dhe anijeve në det, shërbimet e sigurisë dhe mbrojtjes ndaj zjarrit, shërbimet e lidhjeve-zgjidhjeve të anijeve, atë të pilotimit të tyre, aktivitetet e agjensisë detare dhe spacionere, doganore, tërheqjen e mbeturinave të ngurta, vajore dhe të lëngshme nga anijet, shërbimet kundër ndotjes së porteve dhe të hapësirave detare, shërbimet e sigurisë (*Safety*) në porte dhe radë;
- Ndërmarrjen e zbatimin e kontratave publike dhe private për ushtrimin e shërbimeve në aktivitetet që kryhen në ujërat detare kombëtare dhe ndërkontinentale;
- Transportin detar të pasagjerëve dhe mallrave të të gjitha llojeve dhic strukturave me mjete e veta apo të çarteruara;
- Trajinimit të Detarëve dhe të drejtueve të mjeteve të lundrimit ne perputhje me standartet ISO: 9001:2015, zhvillimin e kurseve detare & operatoreve të industrisë detare;
- Punime të të gjitha kategorive të veprimitarisë detare dhe ujore, impektive nënënjore dhe kryerjen e matjeve batimetrike të reliefëve nënënjore detarë;
- Shërbimet për tërheqjen e grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhic të lëngshme të mjeteve lundruese dhe anijeve, në porte, det të hapur apo në spirancë në rada;
- Shërbimet e mirëmbajtjes së aseteve dhe objekteve portuale, në marina dhe të sipërfaqeve ujore të tyre;
- Shërbimin e dhënicës së asistencës anijeve në det, platformave lundruese dhe kërkimore, për nxjerjen e hidrokarbureve, pontoneve, qofshin ato fikse apo të lëvizshme;
- Shërbime kantieri për mirëmbajtjen e mjeteve detare, të ndërtimit të anijeve dhe gjithë tipave të mjeteve lundruese;
- Shoqëria mund të kryejë të gjitha llojet e veprimitarive tregtare, të import-exportit, në pronat e luajtshme e të paluajtshme, që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve ekonomike të saj; ajo gjithashtu mund të marrë pjesë në investime në shoqëri e biznese të tjera të të tretëve, si dhe të sigurojë fondet nga palët e treta për ecurinë e qëllimeve të përbashkëta të shoqërisë;
- Të realizojë veprimitari dhe menaxhimin e instalimeve, impianteve dhe teknologjive të ndryshme në fushën e industrisë detare;
- Prodhime impiantesh për aktivitetet petrolierike, administrimin, menaxhimin e shpërndarjen e prodhimeve të naftës e gazit;
- Të humumtojë dhe industrializojë teknologji të reja, sisteme bashkëkohore dhe pajisje, që lidhen me veprimitarinë detare, portuale, të ndërtimit të anijeve të të gjitha llojeve e tipave, si civile, ashtu edhe ushtarake;
- Të ushtrojë aktivitetin e rekondicioneve të tregtisë detare dhe të angazhohet drejtpërdrejt, me veprimet e nevojshme operative dhe administrative në shërbim të pronarëve të anijeve dhe për llogari të tyre, si vendas, ashtu edhe të huaj;
- Pjesëmarrje në investimet industriale dhe tregtare, si dhe në aktivitete të ndryshme financiare, tregtare e industriale.

## PJESA II

### KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT

Neni 7  
Kapitali i Shoqërisë

7.1 Kapitali i regiszruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TEUTA SAILING" SHPK është 10000 (dhjetë mijë) leke , i cili është nënshkruar nga Bujar MERSINI, ortak i vetem, dhe persaqeson 1(nje) kuote, te kapitalit themeltar te shoqerise.

### **PJESA III STRUKTURAT DREJTUESE TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

#### **Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar**

8.1 Ortakët e kanë përgjegjësi deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria çshëtë përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

#### **Neni 9 Të drejtat e lidhura me edo kuotë**

9.1 Çdo pjesë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendëtë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishjeje apo likuidimi të Shoqërisë.

#### **Neni 10 E drejta e pjesëmarrjes në mbledhjet e Asamblesë**

10.1 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e Shoqërisë në mbledhjet e Shoqërisë.

10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e shoqërisë personalisht ose nëpërmjet një personi përfgaqësues me prokurë, të informohet mbi cështjet e Shoqërisë, si dhe të inspektojë dhe kontrollojë librat dhe registrat e Shoqërisë.

#### **Neni 11 Detyrimet e Ortakëve**

Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjene e veprimeve të saj, si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

### **PJESA IV ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 12 Të drejtat e asamblesë së përgjithshme**

12.1 Asambleja e përgjithshme çshëtë organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e vepritarisë së saj.

12.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.

- 12.3 Vetëm asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjeës së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - vendimin mbi përjashtimin e një ortaku në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
  - të japë të drejta nënshkrimi dhe/ose mundësi zëvendësimi për aksionet në shoqëri;
  - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhc/ose cdo lloj pagimi të pjesëshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
  - bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - hapjen dhe mbylljen e degëve dhe përfaqësive;
  - miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërite si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajthshme;
  - marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejtë për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
  - të vendosë për investimet;
  - të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie;
  - të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
  - të japë dhe të heqë prokura ose autorizime për të vepruar në emër të shoqërisë;
  - të caktojë shpërbilimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
  - të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose pagesat mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
  - të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
  - caktimin e auditorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve;
  - miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
  - ngritjen e padive kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë apo ortakëve;
  - përcaktimin e strukturës organizative dhc administrative të Shoqërisë;
  - përcaktimin e buxhetit vjetor;
  - miratimin e cdo cështjeje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së ortakëve në përputhje me ligjin dhe Statutin.
- 12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cëshje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

#### Neni 13 Vendimet e asamblesë së përgjithshme

- 13.1 Vendimet e renditura për sa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me  $\frac{1}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 13.2 Në mbledhjet e ortakëve votimi është i hapur. Në raste të vecanta dhe përcaktimin e votave, një vendim mund të merret i fshehtë në përputhje me dispozitat ligjore.

#### Neni 14 Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë osc në cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 përqind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen edhe cështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përsaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.

14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së përgjithshme do të tregojë datën, kohën dhe vendin e takimit, si dhe cështjet e rendit të ditës, dhe në rastin e një asambleje të zakonshme ië ortakëve do të përfshijë gjithashtu dhe pasqyrat financiare dhe raportin e administrimit.

14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qenë prezent, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.

14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezent në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakort.

#### Neni 15

#### Vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme

15.1 Vendimet në asamblenë e përgjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet në asamblenë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

15.2 Prokura duhet të jetë e noterizuar dhe të paraqitet në mbledhjen e asamblesë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përsaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblesë, të cilët do të janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.

15.4 Nëse mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite. Mbledhja e dytë e ortakëve ka të drejtë të marrë vendime mbi cështjet e caktuara në rendin e ditës pavarësisht nga kuorumi (numri i kuotave të përfaqësuar).

15.5 Vendimet e mbledhjes së ortakëve mund të merren dhe pa takimin e ortakëve p.sh.:me anë të korrespondencës së shkruar, telekonferencës, videokonferencës dhe të tjera mënyra të ngjashme – nëse të gjithë ortakët kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak dhe identiteti i ortakëve mund të përcaktohet në mënyrë të poadyshimtë.

#### Neni 16

#### Drejtimi i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme do të caktohet nga ortakët.

16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuara shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblesë. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlqimin e tyre

#### Neni 17

#### Procesverbali i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

17.1 Për cdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalistit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalistit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbali i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

17.2 Prosesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalistit.

17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalistit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.

17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalistit dhe shpërndarjen e tij.

## PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### Neni 18 Administrimi i shoqërisë

18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë administratorë, të cilët do të përfaqësojnë Shoqërinë.

Administrator i Shoqërisë do të jetë Zonja **BJANKA SHEHI** per një periudhë prej 2 (dy) vjet nga data e krijimit te Shoqërise.

18.2 Administratorët mund të autorizojnë palët të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.

18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.

18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe rregullat e brenshme të administrimit të Shoqërisë.

18.5 Duke marrë parasysh kufizimet e Nenit 12 më sipër, administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:

- Përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- Hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- Marrjen e huave në emër të Shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huasë;
- Përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
- Përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhëpagesave;
- Nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, nxjerjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat, etj., pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- Mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënieve;
- Dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- Punësimin dhe shkarkimin e Stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- Marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërbimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin poditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresin procedimet;
- Administratorët kanë të drejtë të marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij statuti;
- Mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dëcka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- Thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbrushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- Publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;

- Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- Marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme;

18.5.1 Personi i jashtëm do të caktohet administrator për një periudhë prej 2 vjetësh, me të drejtë ripërtëritjeje:

Specimen i nënshkrimit të administratorit

## **PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

### **Neni 20**

#### **Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare**

- 20.1 Viti finanziar i shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në të tridhjetënjëtën ditë të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën tridhjetënjë të Dhjetorit.
- 20.2 Në fund të edo viti finanziar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - përgatitjen e bilancit të shoqërisë, i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 20.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

### **Neni 21 Fitimi i Shoqërisë**

- 21.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 21.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatumore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

## **PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

### **Neni 22**

#### **Prishja dhe likuidimi**

- 22.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
  - (b) bashkim me një shoqëri tjeter;
  - (c) vendim i gjykatës me juridikcion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 22.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

**PJESA VIII**  
**TË PËRGJITHSHME**

**Neni 23**  
**Të përgjithshme**

23.1 Në rast mosmarrëveshjesh të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpilen t'i zgjidhin ato miqësish. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikcion përkatës.

23.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.

23.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

Ortaku i vetem  
Bujar Mersini



Date 30-06-2020